



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/.nr.19/24

AUTORITETI KOMPETENT I GJKATËS THEMELORE NË PRISHTINË - Kryetarja e Gjykatës Albina Shabani Rama, duke vendosur sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga V.A, ndaj gjyqtares E.Ç, bazuar në dispozitën e nenit 9, paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, me datë 26.09.2024 merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa disiplinore e ushtruar nga V.A ndaj gjyqtares E.Ç, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Me datë 03.09.2024, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duke vepruar konform nenit 9 paragrafi 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë te autoritetit kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga V.A ndaj gjyqtares E.Ç, me arsyetimin se me datë 30.01.2024, gjyqtarja ka mbajtur seancën në çështjen penale ku këtu parashtruesja e ankesës disiplinore është palë e dëmtuar, e cila seancë nuk është zhvilluar me rregull, të njëjtës nuk i është lejuar që të shprehet në mënyrë të rregullt dhe se gjyqtarja nuk e merr parasysh se është palë e dëmtuar dhe është e kërcënuar si dhe nuk e shënon se është invalide.

Me datë 12.09.2024, Kryetarja e Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 paragrafi 5 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga V.A, ndaj gjyqtares E.Ç.

Gjyqtarja E.Ç në deklaratën e saj të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtrueses së ankesës ka deklaruar se pretendimet e palës së dëmtuar nuk janë të vërteta, e njëjta ka theksuar se këtë çështje e ka gjykuar me paanshmëri dhe pavarësi të plotë, duke i respektuar të drejtat e të gjitha palëve në procedurë si në çdo lëndë tjetër dhe lënda tani është në Gjykatën e Apelit sipas ankesës.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtares ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares E.Ç.

Lidhur me pretendimin për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtares mbështetur në arsyetimin se seanca gjyqësore e datës 30.01.2024 nuk është zhvilluar me rregull, autoriteti kompetent gjen se pretendimi i tillë është tejet i përgjithësuar dhe parashtruesja e ankesës nuk ka dhënë asnjë arsyetim specifik, nuk ka ofruar asnjë argument dhe asnjë provë me të cilën do ta dëshmonte faktin se gjyqtarja gjatë udhëheqjes së seancës gjyqësore në fjalë ka ndërmarrë veprime që përbëjnë shkelje të natyrës disiplinore.

Po ashtu, autoriteti kompetent gjeti se pretendimet se gjyqtarja nuk e ka lejuar që të shprehet në seancë apo se gjyqtarja nuk e merr parasysh se është palë e dëmtuar, parashtruesja e ankesës nuk i ka arsyetuar dhe nuk i ka mbështetur me asnjë argument me të cilën do ta provonte faktin se gjyqtarja nuk i ka trajtuar siç kërkohet me ligj palët në procedurë, andaj në këto rrethana e në mungesë të provave, autoriteti kompetent gjeti se pretendimet mbi të cilat është mbështetur janë tërësisht të pabazuara.

Mbi bazën e të lartcekurave, autoriteti kompetent rikujton se me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale në fuqi, janë përcaktuar veprimet që duhet të ndërmerren nga ana e gjykatës në të gjitha fazat e procedurës, e po ashtu janë përcaktuar të drejtat dhe autorizimet e të dëmtuarit në procedurë penale dhe radha e marrjes së deklaratave të palëve në procedurë dhe çdo veprim i gjyqtarit, të cilat pala në procedurë vlerëson se janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, është bazë për të ushtruar mjetin juridik për të cilin vendosin gjykatat e instancave më të larta, e jo bazë për të parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit

Përfundimisht, autoriteti kompetent vlerëson se ankesa disiplinore në përgjithësi mbështetet në pohime të përgjithësuar të ankueses lidhur me drejtimin e procedurës nga ana e gjyqtares dhe pakënaqësitë e saj si palë se gjyqtarja nuk e ka parasysh se është e dëmtuar, mirëpo e njëjta në asnjë mënyrë dhe në asnjë provë nuk e ka argumentuar se gjyqtarja ka ndërmarrë veprime që janë të parapara si shkelje disiplinore nga neni 5 par.1.2 dhe neni 2 par.2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Andaj, autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari E.Ç ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7 paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - AD/GJTHPR/.nr.19/24, me datë 26.09.2024

**Kryetarja e Gjykatës
Albina Shabani Rama**

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtares E.Ç*
- 3. Parashtrueses së ankesës – V.A, lagja Vranjevc, rruga “Vëllezërit Fazliu”, Prishtinë.*